

EJA Kosovë

Angazhimi për Veprim të Përbashkët (EJA Kosovë) është program i KCSF-së që do t'i mbështesë nismat e shoqërisë civile përmes granteve dhe ndërtimit të kapaciteteve me synimin e përgjithshëm për t'i kontribuar një shoqërie demokratike e gjithëpërfshirëse në Kosovë në rrugën e saj drejt integritimit në Bashkimin Europian. E themeluar si mekanizëm i financimit ku disa donatorë i bashkojnë fondet e tyre për përkrahjen e shoqërisë civile, EJA Kosovë aktualisht bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Duke vënë në plan të parë angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve përgjatë tërë punës së shoqërisë civile, EJA Kosovë synon të kontribuojë drejt dy qëllimeve kryesore ku: (a) shoqëria civile shfrytëzon hapësirat për avokim dhe synon krijimin e mundësive/hapësirave të reja për pjesëmarrje të qytetarëve dhe qytetareve në formësimin e çështjeve me interes publik dhe (b) organizatat e shoqërisë civile forcojnë lidhjet me qytetarë dhe përmirësojnë llogaridhënien dhe transparencën ndaj anëtarëve dhe publikut të gjerë.

EJA Kosovë bazohet në premisën që përmes sistemeve të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies nga njëra anë, dhe qasjes dhe komunikimit më të mirë me qytetarë, nga ana tjetër, OShC-të do ta përbrendësojnë praktikën e përfshirjes së qytetarëve në punën e tyre dhe do të zhvillojnë një bashkëpunim më të thellë duke i kontribuar kështu drejtpërdrejt forcimit të lidhjes me grupet e qytetarëve për të cilët angazhohen. E kombinuar me qeverisje të brendshme më të mirë dhe transparencë e llogaridhënie të shtuar, EJA Kosovë pritet të rrisë besimin në shoqërinë civile si një platformë e përshtatshme për t'i shprehur shqetësimet e qytetarëve.

EJA Kosovë do të mbështesë nismat që do të përqendrohen në adresimin e të drejtave dhe nevojave të grupeve të marginalizuara, përkatësisht grave, personave me aftësi të kufizuara, romëve, ashkalinjve, egjiptianëve dhe pakicës serbe, LGBTI, të moshuarve dhe të rinjve. Aktivitetet e mbikëqyrjes, monitorimi i zbatimit të politikave dhe legjisllacionit, kontributi në temat kontraverse, përmirësimi i përfaqësimit të grupeve të marginalizuara, krijimi dhe shfrytëzimi i hapësirave publike, ngritja e vetëdijesimit dhe edukimi në luftimin e stereotipeve gjinore dhe përfaqësimi i grupeve të nënpërfaqësuar do të ishin si ilustrime të disa prej nismave që do të mbështeten dhe përshtaten brenda teorisë më të madhe të ndryshimit të këtij programi.

Bashkëfinancuar nga:

Informata për programin

Qëllimi i përgjithshëm	Mbështetje për zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë në rrugën e saj drejt integritimit në BE.
Rezultatet	<p>1. Shoqëria civile shfrytëzon hapësirat për avokim dhe synon krijimin e mundësive/hapësirave të reja për pjesëmarrje të qytetarëve në formësimin e çështjeve me interes publik;</p> <p>2. Organizatat e shoqërisë civile forcojnë lidhjet me grupet e qytetarëve për të cilët angazhohen, dhe përmirësojnë llogaridhënien dhe transparencën ndaj anëtarëve dhe publikut të gjerë.</p>
Fushat prioritare	<p>Programi synon t'i kontribuojë angazhimit të shtuar qytetar për të ndikuar në prioritetet, planifikim, vendimmarrje dhe zbatim të politikave publike në qeverinë lokale e qendrore, me fokus të veçantë në fushat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje më e lartë e grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara në planifikimin buxhetor • Përmirësim i të drejtave socio - ekonomike e kulturore të grupeve të marginalizuara • Forcimi i rolit të shoqërisë civile në avokim dhe mbikëqyrje, me theks të veçantë në të drejtat dhe nevojat e grupeve të marginalizuara • Fuqizim i të rinjve për të marrë pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave • Edukim qytetar për të drejtat e njeriut
Buxheti	3,1 milion euro (2020-2024)
Përfituesit e skemës	OJQ-të, nismat qytetare të peregjistruara dhe aktivistët (si individë)
Mbulimi gjeografik	Kosovë, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror
Instrumentet e financimit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Grante institucionale 2. Grante për zhvillim organizativ 3. Grante për projekte 4. Grante urgjente 5. Çmimi për demokraci
Numri i prituri i granteve	Mbi 90 grante
Informacionet për kontakt	<p>www.kcsfoundation.org</p> <p>ejainfo@kcsfoundation.org</p> <p>+383 (0)38 600 644</p>